



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



11-01-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 38-2021

Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 39 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 3.1 dhe 3.3 të Rregullës Zgjedhore 12/2013 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me 11.01.2021, merr këtë:

### VENDIM

#### Për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton kufirin e sipërm të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 14 Shkurt 2021, në shumën prej 934, 831 € (nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e një euro).
- II. Neni 3.1 Rregullës Zgjedhore nr. 12/2013 parasheh që kufizimi i shpenzimeve të fushatës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës do të jetë 0.5 euro për votues të regjistruar. Numri i votuesve sipas listës preliminare të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës është 1,869,662 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) votues të regjistruar.
- III. Shpenzimet maksimale për fushatë nga pika 1 e këtij vendimi zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllimet e fushatës që do të zgjasë nga data 3 shkurt 2021 deri më 12 shkurt 2021, pa marrë parasysh kohën e blerjes së shërbimeve.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Valdete Daka, Kryetare